UDHEHEQES I DASHUR E I SHTRENJTE I POPULLIT TONE

The electronic version of the book is created by
http://www.enverhoxha.ru

UDHEHEQES
I DASHUR
E I SHTRENJTE
I PARTISE
E I POPULLIT
TONE

UDHEHEQES I DASHUR E I SHTRENJTE I PARTISE E I POPULLIT TONE

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1968

Ky album nuk është thjesht historia e një njeriu të shquar, që lindi 60 vjet më parë, më 16 tetor 1908, në Gjirokastër, kur në pyjet dhe në malet e Shqipërisë endeshin komitët që luftonin kundër zgjedhës otomane.

Ky album nuk është një regjistrim i thjeshtë datash biografike, një grumbullim fotografish, që shënojnë etapa të caktuara të jetës së një njeriu të shtrenjtë.

Në këtë album është Shqipëria vetë, lufta ngadhënjyese e popullit shqiptar në vitet më të lavdishme të historisë së tij, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, që themeloi, rriti e kaliti shoku Enver Hoxha.

Në këtë album buçet urimi i dalë nga zemra: «Jetë të gjatë shokut Enver, të rrojë sa malet tona për të mirën e partisë, të popullit, të socializmit ngadhënjimtar!»



Në këtë dhomë, në atë 8 Nëndorin e vitit 1941, në Tiranë, nisi një epokë e re në historinë e Shqipërisë: shoku Enver themeloi partinë. Tani është një çast i gëzuar dhe prekës njëkohësisht të ulesh përsëri, 25 vjet më pas, rreth këtyre tavolinave historike, duke patur pranë shokë besnikë të luftës dhe të fitoreve.

Këto fotografi, si çdo fotografi, janë të heshtura. Por ne dëgjojmë Urdhërin e Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-çlirimtare që fton për sulm dhe fitore, dëgjojmë hapin e partizanëve, që parakalojnë para shokut Enver.

Kujtim i dashur tok me Heroin e paharruar të Popullit, punëtorin Vasil Shanto.

Përherë midis luftëtarëve. Diku më tej partizanët ndoshta këndojnë një këngë të re trimash

Në atë ditë të vitit të fundit të robërisë, kur shoku Enver tok me doktor Medar Shtyllën erdhi në këtë fshat malor, kësaj cuce të vogël i ra një fat i madh — të mbetet gjithnjë në kujtesën e popullit pranë udhëheqësit të shtrenjtë.

Dhe arriti vjeshta e madhe e vitit 1944. Në Beratin e çliruar shoku Enver njoftoi krijimin e Qeverisë Demokratike.

Kush ja dhuroi ditën e çlirimit, shokut Enver këtë tufë me lule? Kjo s'ka rëndësi. Këto lule janë shprehja e paharrueshme e mirënjohjes së popullit për udhëheqësin, për shokët e tij të armëve, për çlirimtarët.

Brez pas brezi do të përkujtohet dita plot diell e 11 Janarit 1946. kur në mbledhjen e Asamblesë Kushtetonjëse shoku Enver Hoxha shpalli Republikën Popullore të Shqipërisë.

Kjo është vatra e shtëpisë, ku shoku Enver lindi dhe kaloi fëmininë. Këtu ai dëgjoi rrëfimet e para për kryengritësit sypatrembur të Rilindjes sonë.

Këta fëmijë të Gjirokastrës, ashtu si gjithë fëmijët e Shqipërisë e nisin jetën duke dëgjuar tregimet për partizanët heroikë të udhëhequr nga Enver Hoxha, ata e nisin jetën me shallin e kuq në qafë dhe me thirrjet e gëzuara «Parti - Enver, jemi gati kurdoherë!»

«Giaku dhe koskat e shenjta të bijve dhe të vashave tuaja që mbrujtën dhe forcuan themelet e Shqipërisë së re, jane altari i shenjtë i kombit, ku i gjithë populli ynë, i bashkuar e i organizuar, do të marrë çdo ditë e përherë forcën e shpirtit që do të na çoje përpara, drejt përparimit dhe lulëzimit, drejt idealeve për të cilat ata ranë dëshmorë».

Që të rriten përgjithmonë të lirë brezat e Shqipërisë dhanë jetën e tyre njezet e tetë mijë dëshmorë.

— Nënë e Asim Zenelit! Biri yt dëshmor rron, nënë, në zëmrat tona, zëri i tij do të gjëmojë burrëror përjetë nga Gryka e Mezhgoranit.

Dhe ti, moj nënë e Shkurte Carës, e Heroinës mirditore, që e masakruan armiqtë e popullit në vitet e para të lirise të jesh krenare siç ke qenë gjithmonë.



Kjo cucë e vogël, bija e dësh-morit komunist Bardhok Biba që e vranë në pusi diversantët...

... tani është bërë mësuese e përhap mësimet e partisë, të shokut Enver.

Nga Kongresi i parë i Partisë në të pestin — një rrugë e tërë e lavdishme përmes furtunash e fitoresh.

PROLETARE TE TE GJITHE VENDEVE BASHKOHUNI
KONGRESI
5 I P P SH

Midis përfaqësuesve të klasës punëtore në Kongresin VI të Bashkimeve Profesionale.

Çdo 1 Maj brezat e Shqipërisë janë mësuar ta përshëndesin shokun Enver në tribunën e festimeve, të rrethuar nga shtabi i çelniktë, që na udhëheq me besnikëri të patundur.

Shoku Enver është aty ku kaliten njerëzit e rinj...

...aty ku prodhohet çimentoja për ndërtimet vigane anembanë Shqipërisë...

...aty ku minatorët nxjerrin nga thellësia e tokës pasuritë e çmuara...



...aty ku të shurdhon zhurma e maqinave të prodhimeve prej metali...

...aty ku ndërtohen hidrocentrale vigane.

Ai dekoron punëtorët veteranë, ata që të parët çanë malet me zjarrin e partisë në gji.

Ditët e reformës agrare, kur fshatarët gunëgrisur merrnin tapitë e tokave...

**…dhe një familje e Krutjes sot, që ndër të parat përqafoi rrugen e kolektivizimit të bujqësisë.
Në këtë familje prej njëmbëdhjetë frymësh shoku Enver na ngjan i dymbëdhjeti pjesëtar.**

Ky bisedim mund të bëhet vetëm midis nënës dhe birit.

Këto gra kanë ardhur nga malësitë e largëta në kryeqytet, në kongresin e tyre. Me fjalën e shokut Enver ato u ngritën në luftë për të dërmuar kanunet e egra, paragjykimet e bestytnitë, për t'u bërë ndërtonjëse të denja te socializmit.

Këta fshatarë të kooperativës bujqësore «Partizani» të Krujës, që duke ndjekur mësimet e partisë, braktisën jetën e vetmuar, dhe ndërtuan një jetë të re e të begatshme, e numërojnë shokun Enver, si gjithë kooperativistët e Shqipërisë, anëtar të nderuar të kooperativës së tyre.

Çdo vizitë e shokut Enver anembanë Shqipërisë kthehet përherë në ditë gëzimi e feste.

Si motrat me vëllanë.

Kështu mund të qëndrojnë të përqafuar vetëm atë e bir.



— Pa ndizo njëherë, xhaxha, e të kujtojmë kohën e kaluar, kur luftonim me pushkë në dorë këtyre viseve kundër fashistëve, zengjinëve e bejlerëve.

Midis kooperativistëve të Trashanit.

— Të rrokim kazmën tok, ashtu si pushkën, motra kooperativiste, që ta bëjmë Shqipërinë të lulëzuar, të fortë edhe të begatshme.

Çdo vepër e re, është e lidhur me emrin e udhëheqësit tonë të dashur. Një çast i paharrueshëm: inaugurohet Pallati i madh i Kulturës në Tiranë.

Shqipëria analfabete ka tani shkollat e veta të larta. Në Universitetin Shtetëror të Tiranës shoku Enver viziton laboratoret, ku studentët, duke vënë në jetë porositë e partisë, lidhin teorinë me praktikën.

Rruga e inteligjencies sonë popullore ndritet nga idetë e mëdha të partisë dhe nga mësimet e shokut Enver. Shkrimtarët dhe artistët tanë frymëzohen nga populli dhe krijojnë për popullin.

Në këtë sallë të Kongresit të pestë rinia jonë heroike zotohet të verë në jetë mësimet e shokut Enver: «Të mësojmë, të punojmë dhe të jetojmë në mënyrë revolucionare.»

Takim i përzëmërt me ata që ju qepën kodrave dhe maieve për t'i bërë të lulëzuara si fushat.

Delegatet e Kongresit VI të gruas premtojnë se do të luftojnë që «të djegin me zjarr e t'i këputin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave.»

Ato ja dedikojnë partisë emancipimin e tyre.

Fjalimi historik i 6 shkurtit 1967 çeli horizont të gjërë për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës sonë.

«Të vazhdojmë të revolucionarizojmë partinë me një këmbëngulje të madhe — ky duhet të jetë preokupacioni ynë me i madh», i porosit ai komunistët e Uzinës «Enver».

«Ademi ishte një komunist heroik i'vërtetë, për të parti, popull dhe Adem Rekë ishin një dhe jo tre», shkruan ai në librin e përshtypjeve të Bigës lundruese.

Në Durrës, shoku Enver takohet me vajzat dhe nuset, që shëmbën një botë të tërë me padrejtësi, paragjykime dhe errësirë, dhe erdhën në kurs nga malësitë për t'u bërë përhapëse të së resë në fshat.

Babai i Shkurtes, Pal Vata që zuri vendin e së bijës në aksionin e rinisë, në hekurudhë, ka ardhur në Tiranë tok me mbesën e tij për të kuvenduar me shokun Enver.

Edhe brigada e Shkurtes bisedon me shokun Enver. Një bije, mijëra ngrihen.

Drita e partisë i dha sy të verbërit Fuat Çela. Të parat fjalë që mësoi të shkruante trimi i Skraparit qenë «Parti — Enver».

Shoferët tanë heroikë, në borë e në akull, por me zjarrin e partisë në zemër shpijen në Dibër e Librazhd lëndët e ndërtimit për të zhdukur pasojat e tërmetit.

Parti e popull, të bashkuar si një trup i vetëm, dërmoj në çdo armik e mposhtin çdo fatkeqësi.

Pas tërmetit gëzimi hyn përsëri në shtëpinë e re.

Një tufë lulesh të freskëta për ditëlindje.

Më shumë se një çerek shekulli lufton e punon partia dhe shoku Enver, që jeta e fëmijëve të jetë e gëzuar.

«Brezi i ri duhet të jetë i fortë e i kalitur si nga pikëpamja ideologjike ashtu dhe nga ajo politike, kulturale, ushtarake dhe shkencore...»
— u tha ai nxënësve të shkollës «Themistokli Gërmenji» në Korçë.

Gëzimin dhe të ardhmen e lumtur ata ja dedikojnë partisë.

Komandanti dhe ushtari.

Ushtria jonë popullore, që mbron me vigjilencë fitoret e Shqipërisë socialiste, është e pajisur me teknikë moderne.

Takime të përzëmërta me ushtarët.

Gati për mbrojtje!...
Gati për punë!

TRE PËRVJETORË TË LAVDISHËM:

Vlorë 28 Nëntor 1962;

Përmet 24 Maj 1964,

Krujë, 17 Janar 1968.

Një kurorë në Mauzoleun e Vladimir Iliç Leninit.

Krah për krah me të paharrueshmin Josif Visarionoviç Stalin.

Farkëtonjësit e miqësisë së pathyeshme shqiptaro-kineze.

Partia jonë lufton në arenën ndërkombëtare si një brigadë sulmuese e socializmit, si luftëtare e flaktë konsekuente dhe pa kompromis kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Ndaj miqtë e huaj, të ardhur nga vise të ndryshme të botës, takohen përzemërsisht me shokun Enver Hoxha...

...dhe e përshëndesin atë me grushtet lart.


ENVER HOXHA
RAPORT
MBI VEPRIMTARINË E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË
MBËRTHYER NË KONGRESIN V TË PPSH
1 NËNTOR 1966
ENVER HOXHA
RAPORT
MBI ROLIN DHE DETYRAT E FRONTIT DEMOKRATIK NË LUFTË PËR FITOREN E PLOTË TË SOCIALIZMIT NË SHQIPËRI
MBAJTUR NË KONGRESIN IV TË FRONTIT DEMOKRATIK TË SHQIPËRISË
14 SHTATOR 1967
SHOKU ENVER HOXHA
PËR RININË
ENVER HOXHA
MBI PROBLEMIN E GRUAS
TIRANË 1967
ENVER HOXHA
ENVER HOXHA
VEPRA
1
ENVER HOXHA
REVOLUCIONARIZIMI I MËTEJSHËM I PARTISË DHE I PUSHTETIT
ENVER HOXHA
NË PUNË E NË LUFTË NE DUHET TË MËSOHEMI TA ORGANIZOJMË PUNËN GJITHNJË E MË MIRË NË MËNYRË KRIJUESE
ENVER HOXHA
MBI KOOPERIMIN DHE REVOLUCIONIN TEKNIKO - SHKENCOR
ENVER HOXHA
PËR REVOLUCIONARIZIMIN E MËTEJSHËM TË SHKOLLËS SONË
TIRANË 1968

SHTYPUR NE SHTYP. - PULLAVE POSTARE
TIRANE